D E K L A R AT Ë
18 janar 1999

Kuvendi i Shqipërisë mësoi me zëmëratën më të thellë për masakren e përbindshme të 14 janarit 1999 të kryer nga forcat ushtarake serbe mbi popullsinë shqiptare të Reçakut në Shtimlie të Kosovës. Duke u shprehur ngushëllimet vëllazërore familjeve të viktimave, Kuvendi deklaron se do të impenjohet deri në fund që të ndalet dora gjakatare e Milosheviçit, dhe që ai e banda e tij të dalin para gjykatës nderkombëtare.

Kuvendi vëren me shqetesim të thellë se:

- Milosheviçi po kryen gjenocid, të shoqeruar me makabritetet e ushtruara edhe më parë nga bandat çetnike; i kryen këto mizori nën sytë e gjithë botës dhe në të njëjtën kohë ka guximin të mohojë e të akuzojë nga ana e vet institucionet ndërkombëetare për shpifje. Një cinizëm i tillë gjen shëmbëllim vetëm me aksionet fashiste gjatë shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore, kurse sulmi i ushtrisë serbe për t'u rikthyer në Reçak që të mbulojnë krimin nën dhe e të zhdukim dëshmitarët e mbetur gjallë, shkon përtej botëkuptimit njerëzor;

- Qeveria serbe në fakt ka hedhur në erë marrëveshjen Hollbruk - Milosheviç, ajo nëpërkëmb haptas premtimet; operacionet ushtarake vijojnë si më parë, kurse dhuna, terrori dhe masakrimi i shqiptarëve nuk po njohin kufi;

- ideja për të qetësuar gjendjen në Kosovë me anë të vëzhguesve nderkombëtare nuk përbën pengesë përforcën ushtarake serbe në rrugën e saj të dëbimit dhe zhdukjes fizike të 2 milion shqiparëve në Kosovë. Vëzhguesit po shikojnë aty krime të llahtarshme që nuk i kanë parë kurrë , por ajo që mund të bëjnë, është të flasin për këto krime:

- paralajmërimet e strukturave euro - perëndimore s'kanë bërë asnjë efekt mbi Milosheviçin, i cili po riciklon me forcë të re në Kosovë të njëjtën strategji që përdori në Bosnje deri në ndërhyrjen ushtarake të NATOS-s. Bota është tronditur me ngjarjen e Reçakut dhe prapë dëgjohen zëra të autorizuar se nuk do të lejojnë përsëritje të krimeve të tilla. Kuvendi ynë ka bindjen se edhe këto paralajmërime do të bien në vesh të shurdhër si më parë. Toleranca e pakuptueshme ndaj Milosheviçit dobëson besimin e popujve në rendin botëror dhe në frytshmërinë e strukturave mbrojtëse euro-perendimore. Kjo dukuri krijon precedente të rrezikshëm për të ardhmen e popujve, sidomos në rajonin e Ballkanit;

- gjendja në Kosovë është ndërlikuar edhe më tepër nga paqartësia dhe paqendrueshmëria e zgjidhjeve politike që u janë ofruar palëve nga personalitetet ndërmjetësuese. Populli shqiptar i Kosovës, i gjakosur rëndë prej njëqind vjetësh nuk mund t'i zërë besë asnjë zgjidhjeje politike pa garanci ndërkombëtare të qarta e të forta;

- janë rritur në shkallë tepër të rrezikshme agresiviteti dhe provokacinet serbe ndaj Republikës së Shqiprësië . Kuvendi ndjen detyrën të paralajmërojë përsëri se acarimi serb ndaj Shqipërisë çon në destabilizimin në Bosnje, në Maqedoni dhe në gjithë Europën Juglindore.

Nisur nga realiteti në Kosovë e në rajon, Kuvendi përsërit me forcë thirrjen që ka bërë në disa rezoluta radhas, për ndërhyrjen ushtarake të NATO-s. Miloshevici po asgjëson gjithë shpresat për ndonjë zgjidhje tjetër. Qe Kosova të mos përmbytet në gjak dhe flakët e luftës të mos përfshijnë vendet fqinje, NATO-ja duhet të godasë sot, sepse nesër paqja do të paguhet shumë shtrenjtë.

Kuvendi dhe i gjithë kombi shqiptar, kanë qenë e janë për një zgjidhje paqësore të çështjes së rëndë të Kosovës dhe i kanë shërbyer me durim e sakrifica këtij qëllimi. Por ndjekja, shtypja dhe masakrimi i popullsisë shqiptare të Kosovës ,që arriti në Reçak një nga pikat më kulmore, po e kthen brengosjen e shqiptarëve në dëshpërim. Ndodhemi para alternativës të jetës a te vdekjes të një pjese të madhe të Kombit. Ndodhemi para një lufte të përgjithshme në Kosovë, e cila nuk do të ketë kthim mbrapa.

Kuvendi u bën thirrje pa dallim gjithë shqiptarëve, të bashkohen e të qëndrojnë fort në mbështetje të Kosovës. Si hap të parë të domosdoshëm, Kuvendi shikon unifikimin e menjëhershem të drejtimit politik e të rizistencës në Kosovë, që duhet të arrihet në ditët e

ardhme. Shpëtimi ynë do të vijë në radhë të parë nga vete duart tona.

Kuvendi miraton vepritmarinë serioze e plot përgjegjësi të Qeverisë lidhur me zhvillimet e fundit në Kosovë dhe gjenocidin në Reçak e zonat e tjera të saj. Krahas veprimtarisë së dëndur diplomatike , Qeveria të rriti me ngut përgatitjet për mbrojtjen e vendit dhe t'i përgjigjet me goditje të vendosur çdo shkeljeje të integritetit.

Me anë të kësaj deklarate, Kuvendi konfirmon edhe njëherë se populli i Shqipërisë nuk do t'i lërë për asnjë çast vellezërit kosovarë në mëshirën e serbomedhenjeve gjakatarë. E ardhmja e Kosovës është e lidhur me të ardhmen e Shqipërisë dhe të të gjithë rajonit.

Tiranë, më 18 janar 1999